



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:049668  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05723728

**Ac.nr.3628/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.G., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, me numër personal ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.K., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur - Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale “Shtjefën Gjeçovi”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson F.G., avokate shtetërore në Avokaturën Shtetërore të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensimi i ushqimit gjatë punës, si dhe shpenzimeve të udhëtimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1763/20, të datës 01.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e paditësit B.G., nga fshati ..., Komuna e Podujevës, **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1763/20, i datës 01.03.2021, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin atakuar C.nr.1763/20, të datës 01.03.2021, ka vendosur si në vijim: “I. Gjykata Themelore në Prishtinë, Shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së paditësit B.G. nga Prishtina, me numër C.nr.1763/20, të datës 05.05.2020, kundër të paditurës Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur, Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale “Shtjefën Gjeçovi”, lidhur me çështjen e kompensimit të ushqimit gjatë punës (shujtave), si dhe shpenzimeve të udhëtimit. II. SHPALLËN TË PAVLEFSHME të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ana e kësaj gjykate në këtë çështje kontestuese. III. HUDHET POSHTË SI E PA LEJUAR padia e paditësit B.G. nga Prishtina, me numër C.nr.1763/20, e datës 05.05.2020,

kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, lidhur me çështjen kompensimit kompensimit të ushqimit gjatë punës (shujtave), si dhe shpenzimeve të udhëtimit”.

Kundër këtij aktvendimi paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja juridike kontestimore të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose të ndryshoj aktvendimin e atakuar duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 208 dhe nenin 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit, me datën 05.05.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e pagave jubilarë dhe kompensimin e ushqimit (shujtave), ndërsa me parashtrësën e datës 07.12.2020, dhe 18.12.2020, i autorizuari i paditësit ka bërë precizimin e padisë në kuptim subjektiv dhe objektiv, ku në vend të Komunës së Prishtinës, si e paditur është paraqitur Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për te Rritur - Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale “Shtjefën Gjeçovi”, me seli në Prishtinë, ku nga kjo e fundit ka kërkuar që t’ia bëjë kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në vlerë të 70% të biletave të trafikut urban. Në padi ka parashtruar së paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, në vendin e punës si mësimdhënës i mësimin klasor në SHFMU “Shtjefën Gjeçovi”, në Prishtinë. E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje juridike ka gjetur së çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje administrative, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e këtij kontesti kompetente është Këshill i Pavarur Mbikëqyrës, ashtu që ka marrë aktvendimin e atakuar C.nr.1763/20, të datës 01.03.2021, me të cilin gjykata e shkallës së parë është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe e ka hedhur poshtë padinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së në bazë të vendimit numër 692/1 të datës 09.12.2019 të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, paditësi nga data 09.12.2019, ka pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit në Shkollën e Mesme të Makinerisë “Shtjefën Gjeçovi”, ndërsa sipas vërtetimit mbi përvojën e

punës me nr.142/18 dhe vërtetimit me nr.145/2, paditësi nga data 24.02.2015, ka pasur pozitën e punës si zëvendës drejtorit i Shkollës së Mesme të Makinerisë Shtjefën Gjeçovi, pozitë kjo që kategorizohet në listën e pozitive të Shërbimit Civil të Kosovës (Katalogu i vendeve të punës në shërbimin civil, janar 2015 me numër rendor 281). Tutje ka arsyetuar së me nenin 16, paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e pavarur mbikëqyrës të shërbimit civil të Kosovës, është përcaktuar se “Nëpunësi civil, apo kandidati për praninë në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës”. Kurse me nenin 22 të po këtij ligji, palëve i është dhënë e drejta që kundër vendimit të këshillit të iniciojnë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente, në këtë rast Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Andaj gjykata, ka vlerësuar se nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore për faktin se në këtë rast kemi të bëjmë me të drejtat e pretenduara nga marrëdhënia e punës së shërbyesit civil, marrëdhënie kjo e rregulluar me ligj të veçantë, në të cilin ligj janë përcaktuar edhe organet e përkatëse për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave, ashtu që paditësi procedurën për zgjedhjen e kërkesës së tij do të duhej ta ndiqte në procedurë administrative, pranë këtu të paditurës, e pastaj nëse me vendimin e të paditurës do të ishte i pakënaqur, çështja të dërgohej në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, si organ kompetent për të shqyrtuar ankesat kundër vendimeve të organit të punësimit. Mbi bazën e të dhënave si më lartë, e në bazë të neneve 17,18,19,29 dhe lidhur me nenin 391 par.1 pika “a” e LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181 par.1 e lidhur me nenin 18 par.1 dhe 2 të LPK-së, e që përbejnë arsye për anulimin e këtij aktvendimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se gjykata e shkallës së parë, nuk i ka vlerësuar drejtë dhe me kujdesin e duhur të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në arsyetim të aktvendimit nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse, kur ka ardhur në përfundim që të shpallët jo kompetente në pikëpamje lëndore, që t’i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet e kryera dhe ta hedh poshtë padinë si të palejuar. Kjo për faktin së një mënyrë e tillë e vendosjes arsyetohet vetëm kur për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 18 par.2 të LPK-së. Në rastin konkret objekt kontesti është kërkesa për kompensim të ushqimit gjatë punës dhe shpenzimeve të udhëtimit, për të cilat paditësi pretendon së i takojnë në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, dhe të cilat kërkesa lidhen me marrëdhënien e punës së paditësit tek e paditura. Nisur nga ky fakt rezulton së për zgjidhjen e çështjes objekt i këtij kontesti nuk është kompetencë e organit shtetëror siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, por e gjykatës. Për me tepër, edhe në rast kur gjykata vlerëson së pala paditëse e ka cilësinë e nëpunësit civil, dhe çështja objekt kontesti është administrative dhe procedura duhet të zhvillohet sipas rregullave të konfliktit administrativ, nuk mund ta hedh poshtë padinë si të palejueshme dhe t’i anuloj veprimet e kryera, por duhet të shpallët jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe pasi që aktvendimi të merrë formën

e prerë lënda t'i dërgohet, Departamentit për Çështje Administrative, si gjykatë kompetente. Kjo për faktin së vetëm gjykata kompetente ka kompetencë që të bëjë vlerësime nëse paditësi i ka shterur mjetet e brendshme para se të paraqet padi në gjykatë dhe vetëm gjykata me kompetencë lëndore mund të vendos që ta hedh poshtë padinë si të palejueshme.

Përveç shkeljeve të konstatuara me lartë, gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të kompetencës lëndore, për pozitën dhe kategorizimin e paditësit si nëpunës civil i është referuar katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil, janar 2015 me numër rendor 281, dhe së në këtë rast nuk e ka marrë për bazë kategorizimin që ka pozita të cilën paditësi e ka ushtruar në kohën e marrjes së vendimit, në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.8/2019, 11 mars 2019) me hyrjen në fuqi të secilit ishte shfuqizuar Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës. Duke marrë për bazë nenin 2 par.1, 2 dhe 4 të këtij ligji, rezulton së drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e shkollave fillore dhe të mesme janë nëpunës të shërbimit publik. Lidhur me ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publik të drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe për kompetencën lëndore të gjykatave për zgjidhjen e kontesteve nga marrëdhënia e punës, ka dhënë Mendim Juridik Gjykata Supreme të Kosovës, Nr.42/2023, të datës 27.02.2023. Sipas këtij mendimi në kontestet nga marrëdhënia e punës për drejtorët, zëvendësdrejtorët si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme që kanë lindur pas datës 09 korrik 2020, zbatohen dispozitat Ligjit për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.8/ 11 mars 2019, Prishtinë), si dhe Ligjit të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr.90, datë 01.12.2010), dhe në kontestet e marrëdhënies së punës për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publik, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë dhe gjykohen sipas rregullave të procedurës kontestimore. Kjo për arsye së këto kategori të nëpunësve nuk e kanë statusin e nëpunësve civil por të njëjtit në bazë të Ligjit për Zyrtar Publik, emërtohen me status të ri nëpunës i shërbimit publik, dhe marrëdhënia e punësimit për këto kategori rregullohet me Ligjin për Zyrtar Publik, dhe së për çështje tjera ky ligj i referon në Ligjin e Punës, dhe së për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga marrëdhënia e punës për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publik kompetencë për të vendosur janë Gjykatat-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil.

Në bazë të vërtetimit të përvojës së punës Nr.prot.145/2, të datës 27.02.2020, rezulton së paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në Shkollën e Mesme Profesionale "Shtjefën Gjeçovi" në Prishtinë, ku prej datës 14.12.2004, deri me datë 24.02.2015, ka qenë si mësimdhënës i lëndëve profesionale të makinerisë, ndërsa nga data 24.02.2015, deri me datë 09.12.2019, ka qenë në pozitën e zëvendësdrejtorit, ndërsa pas datës 09.12.2019, vazhdon punën si ushtrues i detyrës së drejtorit të kësaj shkolle.

Duke marrë për bazë së pozita e zëvendësdrejtorit të cilën paditësi e ka ushtruar me parë dhe pozita e drejtorit të shkollës, ku paditësi në kohën e marrjes së vendimit të atakuar, ka qenë ushtrues detyre, sipas Ligjit për Zyrtar Publik, kategorizohet nëpunës të shërbimit publik, dhe duke marrë për bazë edhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit, vlerëson së kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje ka Gjykata, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, sipas rregullave të procedurës kontestimore.

Në kuptim të rrethanave të konstatuara dhe dispozitave të sipërcituara kjo gjykatë vlerëson se vendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të tilla për shkak të cilave çështja duhet të kthehet në rivendosje dhe procedim të serishëm. Gjykata e shkallës së parë mbi bazën e shkeljeve të konstatuara nga gjykata e shkallës së dytë, duke marrë për bazë kërkesëpadinë e paditësit e cila bazohet në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, dhe duke vepruar në kuadër të kompetencës lëndore, pas vlerësimit të provave të paraqitur nga palët ndërgjyqëse, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, dhe vërtetimit të fakteve vendimtare, duhet të nxjerrë vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave të nenit 208 dhe 209 pika d) e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.3628/2021, datë 22.05.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari  
Hysni Bardheci